



Ndërtesa e Elektrokosovës *Elektrokosova Building*
Bulevardi Bill Klinton nr.3 *Bill Clinton Boulevard no.3*
Prishtinë 10000 *Prishtina 10 000*
Republika e Kosovës *Republic of Kosovo*



Raporti vjetor mbi kohën mesatare për lëshimin e Pëlqimit Elektroenergjetikë dhe procedurat e kycjes

Shkurt, 2018



I. Hyrje

Ky dokument është hartua nga KEDS dhe shërben si informator i përgjithshme për konsumatorët mbi procedurat e kycjes në rrjetin e shpërndarjes. Njëkohësisht ofron informata mbi kohën mesatare gjatë së cilës ushtruesit në sektorin privat pajisen me Pëlqim Elektroenergjetikë, respektivisht ofrimin e specifikave teknike të kycjes.

Kycja në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike rregullohet përmes [Metodologjisë për Taksën e Kycjes](#), e cila ofron informata më të plota dhe më të detajuara për aplikuesit dhe përdoruesit e sistemit të shpërndarjes, të cilët kërkojnë kycje të re apo modifikim të kycjes ekzistuese. Në të kaluarën konsumatori duhej të aplikonte për Pëlqim Elektroenergjetikë përmes kompanisë së furnizimit, sidoqoftë kjo praktikë është përmirësuar me aprovimin e [Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike](#) në vitin 2017, duke mundësuar kështu aplikimin e drejtpërdrejtë tek Operatori i Sistemit. Në këtë formë, kjo ka ndikuar edhe në shpejtësinë e ofrimit të përgjigjes tek konsumatori.

II. Procesi i Aplikimit

Përgjithësisht, janë 4 hapa nga momenti kur konsumatori aplikon me kërkesë për kycje në rrjetin e shpërndarjes deri në kohën kur ai praktikisht kycet. Në vitin 2016, legjislacioni i cili rregullon sektorin e energjisë ndryshoi për t'u përshtatur me Paketën e trete të Direktivave të BE-së. Në këtë frymë është hartuar edhe Metodologjia e re për Taksën e Kycjes nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSh), i cili për momentin është duke u rishikuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRE). Në këtë kuptim, është e rëndësishme të theksohet se kurdo që Metodologjia për Taksën e Kycjes në fuqi është në kundërshtim me ligjet e reja të aprovuara, ligjet do të mbizotërojnë. Në këtë kuptim:

1. Konsumatori aplikon për Pëlqim Elektroenergjetikë tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes në distriktin specifik. Distrikti përcjell dokumentet në ndërtesën qendrore (NQ), prej nga ato tutje përcillen tek Departamenti për Pëlqime Energjetike dhe Pranim Teknik të Kompanisë së Shpërndarjes (OSSh). Pas rishikimit të aplikimit, Departamenti për Pëlqime Energjetike dhe Pranim Teknik brenda OSSh-së, ndërmerr analizat e nevojshme dhe lëshon Pëlqimin Elektroenergjetikë.
2. Pas lëshimit të Pëlqimit Elektroenergjetikë (specifikat teknike), konsumatori kontraktton një kontraktues privat për t'i kryer punët e nevojshme në terren, e që në raste specifike mund të kryhen edhe nga vet OSSh-ja. Kontraktuesi kryen të gjitha punët e nevojshme përfshirë: blerjen e materialit dhe marrjen e lejeve të nevojshme (siç është leja komunale për gërmim).
3. Pasi të mbaroj kontraktuesi privat punët në terren, ai fton inxhinierët profesional dhe të thirrur të OSSh-së për të inspektuar punët në terren, përkatësisht inxhinierët inspektojnë nëse punët e



kryera në terren janë sipas specifikave teknike të ofruara nën hapin e parë (Pëlqimi Elektroenergjetikë). Njëkohësisht konsumatori nënshkruan marrëveshjen me Furnizuesin.

4. Nëse OSSH vlerëson se nuk ka çështje tjera, atëherë OSSH ofron njehsorin dhe respektivisht kyçja me energji elektrike vlerësohet si e përfunduar

Ekzistojnë lloje të ndryshme të kërkesave për lidhje, megjithatë nëse aplikacioni plotëson të gjithë dokumentacionin siç kërkohet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, koha mesatare e lëshimit të Pëlqimit Elektroenergjetikë (zgjidhjes teknike) është 5-6 ditë, me një gamë të mundshme devijim.

Dokumentet e kërkuara të nevojshme për aplikim, të cilat mund të gjenden online në faqen e zyrtare të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, janë si më poshtë:

- Aplikimi –i cili mund të merret në formë elektrike apo të printuar tek secili distrikt. Aplikimi kërkon informata të përgjithshme sic janë Emri/Mbiemri, Adresa e saktë (nëse është e mundshme koordinatat GPS), informatat kontaktuese dhe informata mbi destinimin e objektit ndërtimor. Për më tepër, informata shtesë që duhet të ofrohen së bashku me aplikimin janë si në vijim:
 - Kopja e planit
 - Fleta poseduese
 - Kushtet e ndërtimit (të lëshuara nga Kuvendi Komunal)
 - Deklarata për ngrohje
- Certifikata e biznosit
- Projekti elektrik, i hartuar nga kontraktuesi. Projekti elektrik duhet të posedoj përmbledhjen ekzekutive, jo më gjatë se 1 faqe, së bashku me Skemën njëpolëshe elektrike për objektin në fjalë dhe fuqinë e plotë të instaluar (S_{inst}) dhe fuqinë e plotë të njëkohshme (P_{nj}).

Sapo këto dokumente të sigurohen, inxhinier elektrik rishikon punën dhe lëshon zgjidhjen teknike të njohur si Pëlqimi Elektroenergjetikë, së bashku me faturën.

Punët e mëtejme, siç përcaktohet në Pëlqimin Elektroenergjetikë, do të kryhen nga kontraktuesi privat apo në raste të veçanta nga vetë OSSh. OSSh nuk e kontrollon punën në fazat e ndërtimit, përveç nëse kërkohet nga kontraktuesi. Megjithatë, OSSh e inspekton punën në fund, përpara se të ofroj njehsorin elektrike dhe ta lidhë atë me rrjetin e shpërndarjes.

Procesi i kyçjes mund të zgjasë në varësi të kontraktorit privat, megjithatë nga perspektiva e OSSh, lëshimi i Pëlqimit Elektroenergjetikë nuk zgjat më shumë se 5-6 ditë dhe 1 ditë shtesë për inspektime dhe lidhje.



III. Koha mesatare për lëshimin e Pëlqimit Elektroenergjetikë për vitin 2017

Cilësia komerciale përcakton efikasitetin dhe saktësinë e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve, dhe merr parasysh marrëdhënien e ndërsjellë në mes të konsumatorëve dhe furnizuesit.

Në standardet e cilësisë komerciale, përveç tjerash, janë edhe lidhjet e reja, me të cilat regjistrohet se sa shpejt ndërmarrja energjetike merr masa për ekzekutimin e lidhjeve të reja.

Për qëllimet e këtij raporti, dhe pasi shumica e kërkesës për kyçje janë nga bizneset komerciale, ne do të përqendrohemi në kërkesat e tensionit të mesëm. Për më tepër, duke marrë parasysh se ditët mesatare për përfundimin e procesit të marrjes së Pëlqimit Elektroenergjetikë në sistemin e shpërndarjes shpesh varen nga vetë konsumatorët, të dhënat e analizuara ndërlidhen vetëm me rastet në të cilat kërkesa për kyçje nga konsumatorët është e plotë dhe e mbështetur me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

Përderisa në 2016 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSh) ka pranuar gjithsej 830 kërkesa, viti 2017 shënoi një rritje prej 40% në numrin e përgjithshëm të kërkesave të pranuar në OSSh me gjithsej 1.156 kërkesa për kyçje. Megjithatë, 41 prej tyre nuk kanë dorëzuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm siç kërkohet me procedurat e aplikimit, procesi i analizimit, përkatësisht dhënia e Pëlqimit Elektroenergjetikë është zgjatur. Duke pasur parasysh se procesi i vonësive nuk ishte në duart e kompanisë, por vetë konsumatorët, për qëllimet e këtij raporti këto raste do të përjashtoheshin.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i kërkesave të pranuar gjatë vitit 2017 për muaj:

Muaji	Nr. i kërkesave për kyçje në vitin 2016	Nr. i kërkesave për kyçje në vitin 2017
Janar	34	34
Shkurt	57	54
Mars	65	80
Prill	55	77
Maj	75	91
Qershor	46	127
Korrik	63	129
Gusht	51	108
Shtator	63	101
Tetor	60	114
Nëntor	51	105
Dhjetor	49	95
Rastet e përjashtuara	161	41
Total kërkesa	830	1,156

Shënim: Rastet e përjashtuara paraqesin kërkesat me dokumentacionin e pa-kompletuar



Megjithëse numri i kërkesave është rritur, ndërkohë që numri i punonjësve që punojnë në ciklin si në distrikt dhe në selinë qendrore të OSSH-së ka mbetur i njëjtë, ditët mesatare nga momenti kur konsumatorët aplikojnë për t'u pajisur me Pëlqim Elektroenergjetikë (PE) e deri në lëshimin e Pëlqimit Elektroenergjetikë nuk kanë tejkaluar 6 ditë pune, ashtu siç tregohet në tabelën e mëposhtme:

Muaji	Ditët mesatare për lëshimin e PE-së në vitin 2016	Ditët mesatare për lëshimin e PE-së në vitin 2017
Janar	5.83	3.46
Shkurt	6.80	3.35
Mars	5.09	4.68
Prill	7.37	7.08
Maj	6.60	6.89
Qershor	5.66	6.10
Korrik	5.00	6.14
Gusht	5.79	5.98
Shtator	7.27	8.82
Tetor	5.83	8.49
Nëntor	5.82	7.87
Dhjetor	5.57	8.85
Mesatarja	6.05	6.48

Në kuptimin e sektorit të energjisë elektrik, Kosova është e ndarë në 7 distrikte kryesore:

1. Ferizaj
2. Gjakova
3. Gjilani
4. Mitrovica
5. Peja
6. Prishtina, dhe
7. Prizreni

Ngjashëm me trendin e vitit 2016, Distrikti i Prishtinës dhe Distrikti i Ferizajt janë ato me numrin më të madh të kërkesave për kyçje në tensionin e mesëm, ndërsa Distrikti i Mitrovicës është ai numri më të vogël të kërkesave të pranuar për kyçje.



Distrikti	Nr. i kërkesave për kyçe në vitin 2016	Nr. i kërkesave për kyçe në vitin 2017
DFE	133	245
DGJ	58	115
DGL	63	132
DMI	46	77
DPE	62	130
DPR	214	299
DPZ	93	117
Rastet e përjashtuara	161	41
Total	830	1,156

Siç shihet nga tabela e mësipërme, vërehet një rritje në numrin e kërkesave në distriktet e Pejës dhe Gjilanit, të cilat shënojnë një rritje prej 110% krahasuar me vitet e mëparshme.

Një analizë e tillë është shumë e rëndësishme për OSSh-në, pasi kjo tregon edhe interesin e bizneseve, prandaj orienton OSSh-në që të planifikojë siç duhet investimet e saj në tensionin e mesëm. Investimet e tilla do të ndihmonin në ofrimin e shërbimeve më të mira për konsumatorët, duke përfshirë zgjidhje më të shpejta për kyçe.

Siç u tha më parë, koha mesatare e një konsumatori për të pranuar Pëlqimin Elektroenergjetikë është 6 ditë, e megjithëse Prishtina kryeson me numrin më të madh të kërkesave, ky distrikt ka shpejtësinë më të lartë në lëshimin e Pëlqimit Elektroenergjetikë, me një mesatare prej vetëm 5.5 ditë gjatë vitit 2017, e udhëhequr nga distriktet e Gjakovës dhe Prizrenit, siç tregohet në tabelën e mëposhtme:

Distrikti	Ditët mesatare për lëshimin e PE-së në vitin 2016	Ditët mesatare për lëshimin e PE-së në vitin 2017
DFE	6.26	7.95
DGJ	7.65	5.64
DGL	5.75	6.91
DMI	5.79	6.55
DPE	6.05	6.70
DPR	5.35	5.51
DPZ	5.53	6.12
Mesatarja	6.05	6.48



Pasi të mbarohet puna në terren nga kontraktuesi privat, OSSH-ja nuk ka nevojë për më shumë se 1 ditë për të inspektuar dhe lidhur konsumatorin në rrjetin e shpërndarjes, nëse punimet e kontraktuesit janë në përputhje me specifikimet në Pëlqimin Elektroenergjetikë.

IV. Indekset e SAIDI-t dhe SAIFI-t për komunitetin e biznesit

Rrjeti i shpërndarjes është relativisht i vjetër dhe i dëmtuar, prandaj kërkon shumë investime dhe mirëmbajtje. Për të përmirësuar gjendjen ekzistuese, OSSH investon në baza vjetore mbi 22 milionë euro dhe shpenzon edhe 5 milionë shtesë për mirëmbajtjen. Me gjithë këtë sërish ndodhin shumë ndërprerje të paplanifikuara. Kjo për fat të keq ndikon në indekset e SAIDI-t dhe SAIFI-t, dhe stabilitetin e energjisë elektrike në përgjithësi.

Për të siguruar një rrjedhë më të sigurt dhe më të qëndrueshme të energjisë elektrike për sektorin e biznesit, të cilat janë vendimtare për zhvillimin e vendit, OSSH ofron mundësinë e lidhjes së tyre përmes linjave private. Në këtë perspektivë linjat elektrike nuk janë të ngarkuar dhe kështu kemi pak apo fare probleme lidhur me problemet e tensionit siç janë luhajtjet apo cilësia e tensionit.

Në këtë kuptim, ne kemi analizuar indekset e SAIDI-t dhe SAIFI-t vetëm për daljet/linjat e bizneseve dhe analiza për vitin 2017 tregon se për konsumatorët e bizneseve të kyçura në nivelet 35 kV dhe 10 kV indekset SAIDI dhe SAIFI nuk tejkalojnë mbi 5 orë, siç tregohet në tabelën më poshtë:

SAIDI	5.06	4.99
SAIFI	3.71	4.40

OSSH është e vetëdijshme që një situatë e tillë nuk është në nivelin e dëshiruar në nivelin e tensionit të ulët (0.4 kV), ku bizneset e vogla, siç janë dyqanet janë të kyçura, megjithatë OSSH është i angazhuar të investojë edhe më shumë në 5 vitet e ardhshme (me rreth 30 milionë euro në vit) me qëllimin e vetëm që të ofroj shërbime sa më të mira për të gjithë konsumatorët e saj, e cila është në interes të të gjithë akterëve të përfshirë në sektorin e energjisë.